



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**V E N D I M**

**NR. 3/12, DATË 05/ 04/2022**

**PËR**

**MOSPRANIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT INVESTUES, SHOQËRISË  
"AQUATIQ" SH.P.K. PËR KORRIGJIMIN E NJË GABIMI MATERIAL NË  
ZBARDHJEN E VENDIMIT NR. 3/8 DATË 15.07.2021 TË KOMITETIT TË  
INVESTIMEVE STRATEGJIKE "PËR MIRATIMIN E STATUSIT TË INVESTITORIT  
STRATEGJIK PËR REALIZMIN E "FERMËS AKUAPONIKE" "**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 55/2015, "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", Komiteti i Investimeve Strategjike,

**KONSTATOISE:**

- Projekti i investimit strategjik "Fermë Akuaponike" propozuar nga subjekti investues, shoqëria "Aquatiq" sh.p.k., ka përfutuar statusin "Investim/Investitor strategjik, procedurë e asistuar" me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) Nr. 3/8, datë 15.07.2021.
- Zhvillimi i fermës akuaponike prej 146 ha synon të përfshijë disa faza, ku faza e parë pritet të jetë ajo e ndërtimit të fermës fillestare prej 12.25 ha, e cila përbëhet nga disa zona prodhimi (2.75 ha secila zonë) dhe po kështu edhe sipërfaqet e fermave pasardhëse.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka konfirmuar parcela të lira në zonën e kërkuar DJ\_B\_B\_1, Karavasta e Re.
- Masa mbështetëse që i është miratuar subjektit me Vendim të KIS Nr. 3/8, datë 15.07.2021 është dhënia në përdorim e pasurisë së paluajtshme në pronësi të shtetit me sipërfaqe përafërsisht 100 ha, nën administrim të MBZHR.
- Subjekti, pasi është vënë në dijeni të Vendimit të KIS Nr. 3/8, datë 15.07.2021, me

shkresën Nr. 3/1 Prot. datë 15.11.2021 drejtuar Komitetit të Investimeve Strategjike, pretendon se në këtë Vendim, ka një gabim material dhe kërkon që me vendim të KIS të miratohen 27 parcela të zonës DJ\_B\_B1 me një sipërfaqe totale prej 326 ha (sipërfaqe referuar PDZRK Karavasta), ku në këto parcela përfshihen edhe hapësirat ndihmëse dhe ndërlidhëse midis këtyre serave, si rrugë, parkim, kanale, rrjet teknik furnizues midis tyre me qëllim ndërtimin e 146 ha sera (gjurmë ndërtimi/sipërfaqe neto) me vlerë investimi 26 milion Euro dhe krijimin e 1500 vendeve pune.

- Kërkesa e subjektit u diskutua në mbledhjen e XVIII të Komitetit të Investimeve Strategjike dhe me kërkesë të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural, në cilësinë e anëtarit të KIS dhe me dakordësi të anëtarëve të tjerë, me qëllim njohjen me dokumentacionin e plotë të projektit në fjalë dhe vlerësimin e pretendimit të subjektit Komiteti i Investimeve Strategjike, me Vendimin nr. 3/10 datë 02.12.2021 vendosi:

1. *Shtyrjen e vendimmarrjes, për mbledhjen e radhës së Komitetit të Investimeve Strategjike, mbi kërkesën e subjektit "Aquatiq" sh.p.k. për korrigjimin e një gabimi material në zbardhjen e Vendimit Nr. 3/8 datë 15.07.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike "Për miratimin e Statusit të Investitorit Strategjik për realizimin e "Fermës Akuaponike".*
2. *Subjekti të vijojë realizimin e fazave të projektit në sipërfaqen prej afërsisht 100 ha, në pronësi të shtetit shqiptar, të miratuar sipas Vendimit të KIS Nr.3/8, datë 15.07.2021.*

Në përfundim, pas njohjes me dokumentacionin e plotë të projektit në fjalë dhe vlerësimin e pretendimit të subjektit, duke qenë se:

- ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural mban të njëjtin qëndrim, sipas Vendim të KIS Nr. 3/8, datë 15.07.2021, mbi pasuritë e paluajtshme që mund t'i vihen në dispozicion projekti të investimit strategjik;
- pavarësisht kërkesave për masë mbështetëse që ka të drejtë të kërkojë një subjekt aplikues për përfitimin e statusit investim/investitor strategjik për realizimin e projektit, vlerësimi i tyre bëhet në përputhje me interesin publik, duke respektuar parimet e transparencës, të paanshmërisë, të barazisë e të mbrojtjes së konkurrencës dhe tregut të lirë,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës së subjektit investues, shoqërisë "Aquatiq" sh.p.k. për korrigjimin e një gabimi material në zbardhjen e Vendimit Nr. 3/8 datë 15.07.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike "Për miratimin e Statusit të Investitorit Strategjik për realizimin e "Fermës Akuaponike", për shkak se në zbardhjen e vendimit në fjalë nuk ka asnjë gabim material, pasi sipërfaqja e përcaktuar në vendim është pikërisht sipërfaqja që

është dakordësuar kolegjisht për t'u vënë në dispozicion të projektit të investimit strategjik.

2. Subjekti të vijojë realizimin e projektit strategjik në sipërfaqen, në pronësi të shtetit shqiptar, të miratuar me Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.3/8, datë 15.07.2021.
3. Në rast se subjekti nuk dëshiron të zhvillojë projektin strategjik në sipërfaqen e miratuar me Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.3/8, datë 15.07.2021, duhet të njoftojë Komitetin e Investimeve Strategjike brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.
4. Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të revokojë miratimin e statusit investim/investitor strategjik, të miratuar me Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.3/8, datë 15.07.2021, në rast se subjekti nuk e zbaton projektin strategjik sipas afateve që do të dakordësohen në marrëveshjen e investimit.
5. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për njoftimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**